



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 21.2.1-2017-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË  
FINANCAVE  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, prill 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Minsitrisë së Financave), në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Blerim Kabashi (udhëheqës i ekipit), Ariana Rexhëbeqaj dhe Leonora Hasani (anëtar të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymeri.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	9
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	20
5 Qeverisja e mirë.....	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	23
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme .....	26
Shtojca III: Letërkonfirmimi .....	30

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Financave për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, për vitin 2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Financave.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



## Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Ministrisë së Financave (MF). Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë së deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### 1. Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e MF-it për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, nr.01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i MF-it është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të

mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## **2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim**

Nga MF kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit më kohë.



## DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I MF-it

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PVF-ve në MF, është e saktë dhe e drejtë. Gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale.

### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit është menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Për shkak të moszbatimit me konsistencë të rregulloreve, fusha e prokurimit vazhdon të mbetet fusha më shqetësuese, duke u përcjellur me dobësi që mund të rezultojë në vlerë të dobët të arritur për para. Në kontekst të sistemeve financiare, të hyrat në përgjithësi menaxhohen mirë më përjashtim të mungesës së barazimeve mujore më Thesarin, ndërsa kontrollet mbi shpenzimet kërkojnë përmirësim të vazhdueshëm/mëtejshëm. Fushat kryesore ku janë vërejtur mangësi janë realizimi i buxhetit, proceset e prokurimit, si dhe fusha e personelit.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>50,527,899</b>	<b>27,136,408</b>	<b>23,125,136</b>	<b>21,936,786</b>	<b>24,207,614</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	50,527,899	26,811,872	22,813,721	21,479,420	23,412,058
Financim nga huamarrja	0	0	0	87,935	350,021
Donacionet e jashtme	0	324,536	311,415	369,431	445,535

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 23,391,491€. Ky zvogëlim është pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2017, MF së bashku me agjencitë ekzekutive<sup>2</sup> ka shpenzuar 85% të buxhetit final ose 23,125,136€. Mirëpo nëse përjashtojmë mjetet për Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit në vlerë prej 2,705,782€ (i cili nuk menaxhohet nga MF) atëherë realizimi i buxhetit final është 95%, krahasuar më vitin e kaluar është një rritje prej 5%.

Përkundër progresit, në disa kategori realizimi i buxhetit mbetet ende në nivel jo të kënaqshëm..

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>50,527,899</b>	<b>27,136,408</b>	<b>23,125,136</b>	<b>21,936,786</b>	<b>24,207,614</b>
Pagat dhe Mëditjet	32,307,238	15,121,935	15,034,273	15,023,227	14,369,590
Mallrat dhe Shërbimet	5,151,366	6,050,085	5,004,579	5,311,572	5,890,597
Shërbimet komunale	488,592	394,792	311,315	316,892	342,825
Subvencionet dhe Transferet	226,000	1,247,328	1,241,086	288,757	3,103,321
Investimet Kapitale	12,354,703	4,322,268	1,533,883	996,338	501,281

Në tabelën në vijim dhe më tutje në raport paraqesim buxhetin dhe shpenzimet për MF-in, duke përjashtuar të dhënat për Doganën dhe ATK-në.

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> ATK-Administrata Tatimore e Kosovës dhe DK-Dogana e Kosovës

**Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>31,660,586</b>	<b>9,375,688</b>	<b>5,827,256</b>	<b>5,263,086</b>	<b>8,531,511</b>
Pagat dhe Mëditjet	19,455,749	2,585,565	2,497,902	2,546,677	2,537,488
Mallrat dhe Shërbimet	2,217,489	2,232,001	1,551,540	2,345,981	2,780,604
Shërbimet komunale	126,645	55,445	37,735	35,956	47,927
Subvencionet dhe Transferet	226,000	1,247,328	1,241,086	288,757	3,103,321
Investimet Kapitale	9,634,703	3,255,349	498,993	45,715	62,171

Duke ju referuar kësaj tabele, në vitin 2017, buxheti final i MF (pa DK dhe ATK) është shpenzuar 62% ose 5,827,256€. Mirëpo në buxhetin final të MF është futur edhe Fondi në Mirëbesim i cili nuk menaxhohet nga MF dhe nuk figuron në realizim. Nëse përjashtojmë këtë vlerë prej 2,705,782€<sup>3</sup>, atëherë realizimi i buxhetit final është 87%, apo 3% më i ulët se vitin e kaluar.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Zvogëlimi i buxhetit paga dhe mëditje është 16,870,184€. Vlera prej 17,000,000€ kontigjenca për sigurime shëndetësore, me rishikim të buxhetit janë transferuar nga MF në Ministrinë e Shëndetësisë. Vlera prej 185,302€ janë kontigjenca në paga nga Marrëveshja e Brukselit të ndara për MF, me vendim të Qeverisë janë transferuar në organizatat përkatëse buxhetore. Ndërsa një rritje nga donacionet për 324,000€ dhe një zvogëlim prej 8,882€.
- Buxheti për Subvencione dhe transfere është rritur për 1,021,328€. Kjo shumë ishte alokuar për subvencionimin e entiteteve jo publike dhe përmes transfereve për Qeveritë tjera<sup>4</sup>. Rritja e buxhetit figuron në MF/Departamenti i Thesarit pasi kjo kategori e shpenzimeve orientohet/realizohet kryesisht nga vendimet e Kryeministrit, dhe Thesari bënë ekzekutimin e pagesave.
- Kategoria e Investimeve kapitale ka pësuar disa lëvizje: buxheti fillestar ishte 9,634,703€, ndërsa pas rishikimit të buxhetit, me vendim të Qeverisë janë larguar projekti Ndërtimi i Objektivit Doganë-ATK në vlerë prej 2,757,624€, projekti Integrimi dhe zhvillimi i sistemeve të MF-it në vlerë prej 2,327,512€, si dhe fondi i mirëbesimit është zvogëluar për 1,294,218€. Më tej nga buxheti final i MF-it prej 3,255,349€ figurojnë mjetet për fondin e mirëbesimit për Komunitet Veriore në vlerë prej 2,705,782€, të cilat nuk figurojnë në realizim për arsye se nuk menaxhohen nga MF. Andaj buxheti final vetëm për programet në menaxhim të MF-it ishte 549,567€, realizimi është 498,993€ apo 91%.

<sup>3</sup> Këto janë mjete për Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit për Komunitet veriore

<sup>4</sup> Qeveritë tjera jashtë Kosove, ndihmë për çështje humaniteti/solidariteti.

**Çështja 1 – Performancë jo e mirë buxhetore në nivele të kategorive ekonomike**

- E gjetura** Për vitin 2017, ekzekutimi i buxhetit është në nivel 87% në raport me buxhetin final/të rishikuar. Një realizim i dobët vërehet sidomos në kategorinë mallra dhe shërbime 70% dhe shërbime komunale 68%. Kjo për arsye të anulimit të disa aktiviteteve tenderuese si dhe vonesat e shkaktuara nga operatorët ekonomik në realizmin e furnizimeve. Kjo ka ndikuar negativisht në performancën e përgjithshme buxhetore.
- Rreziku** Ekzekutimi i dobët i buxhetit rezulton në shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion. Si rrjedhojë mund të mos-përmbushën aktivitetet operationale që rrezikojnë mos përmbushjen e objektivave të Ministrisë.
- Rekomandimi 1** Ministri duhet të bëj një analizë dhe të identifikoj arsyet për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit për mallra dhe shërbime dhe komunali, duke përcaktuar opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij para përcaktimit të programeve për vitet në vijim.

**3.2 Të hyrat**

Në kuadër të MF përfshirë DK dhe ATK për vitin 2017 janë realizuar 1,478,243,665€ të hyra neto. Ndërsa vetëm MF ka realizuar 373,665€, të hyra nga tri burime, si: a) gjobat ndaj institucioneve financiare; b) të hyrat nga licencimi i aktiviteteve individuale dhe të lira dhe c) të hyrat gjobat tjera të grumbulluara nga Qendra Informativ Financiare (QIF).

Në tabelën vijuese janë të hyrat totale. Por të hyrat nga DK dhe ATK nuk janë pjesë e këtij auditimi, ato trajtohen në raporte të veçanta të auditimit.

**Tabela 4. Të hyrat (në €)**

Agjencitë/ Departamenti	Të hyrat bruto	Kthimet	2017 të hyrat	2016 të hyrat	2015 të hyrat
Dogana	1,121,097,000	(9,144,000)	1,111,953,000	1,044,042,000	944,929,869
ATK	414,356,000	(48,439,000)	365,917,000	355,380,455	304,003,191
NJIF	20,000	0	20,000	12,000	0
Thesari	265,200	0	265,200	282,750	1,468,297
Administrata Qendrore	88,465	0	88,465	79,231	74,464
<b>Totali</b>	<b>1,535,826,665</b>	<b>(57,583,000)</b>	<b>1,478,243,665</b>	<b>1,399,796,436</b>	<b>1,250,475,821</b>

Në vitin 2017 të hyra totale në MF, DK dhe ATK janë 1,478,243,665€, krahasuar me vitin paraprak janë realizuar 78,447,229€ më shumë apo rreth 6%. Rritjet kryesore janë në të hyrat tatimore në Doganë dhe ATK. Nga testimet e kryera për të hyrat e MF-it kemi vërejtur çështjen vijuese:

## Çështja 2 - Procesi i harmonizimit të të hyrave jo në pajtueshmëri me kërkesat ligjore

**E gjetura** Sipas rregullores financiare nr. 03/2012, nenit 13-barazimet e të hyrave pas çdo mbyllje të periudhës mujore, MF është e obliguar që të kryej barazimin e të hyrave me librin e përgjithshëm të llogarive në SIMFK.

MF kishte kryer barazimet tremujore të të hyrave me Thesarin mirëpo mungonin barazimet mujore.

**Rreziku** Mos kryerja e procesit të harmonizimit në baza mujore nuk siguron besueshmërinë dhe saktësinë e informatave/të dhënave të raportuara të MF-it.

**Rekomandimi 2** Ministri duhet të siguroj kontrole të mira në harmonizimin e të hyrave, të identifikohen shkaqet për mungesë të harmonizimit të rregullt-mujor ndërmjet shënimeve të MF-it me të hyrat e regjistruara në SIMFK, dhe të merren veprimet adekuate/përmirësuese.

## 3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve e Ministrisë së Financave për vitin 2017 është 2,585,565€, i cili ishte shpenzuar në masën prej 96%.

## Çështja 3 - Pagat jo në përputhje me akt emërimet

**E gjetura** Bazuar në rregulloren nr.16/2016, për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në MF, zyrtari i lartë i ekzekutimit të buxhetit duhet të ketë koeficientin tetë (8).

Me rastin e ristrukturimit të pozitive në përputhje me këtë rregullore, tre raste kanë kaluar nga pozita shef i sektorit (koeficient 8.5) në zyrtar të lartë i ekzekutimit të buxhetit (koeficient 8). Mirëpo këta ende vazhdojnë të paguhet me koeficientin më të lartë (8.5).

- E gjetura** Departamenti i buxhetit në kuadër të MF-it me qëllim të arritjes së objektivave sipas afateve, angazhon zyrtarët e saj për punë shtesë jashtë orarit të rregullt të punës.
- Listat për pagesën e punëtorëve për punën e bërë jashtë orarit të rregullt nuk përputhen me listat sipas regjistrimit elektronik. Për dy zyrtarë kemi vërejtur se në listën e orëve shtesë është kalkuluar numri i orëve të punës shtesë, mirëpo të njëjtit zyrtar nuk figuronin në listën e ardhje vajtje në punë për datën e caktuar.
- Rreziku** Mos harmonizimi i koeficienteve në përputhshmëri me planifikimet buxhetore dhe me sistemin e gradimit sjellin pagesa të pa pajtueshme me rregullat dhe vështirësi buxhetore për Ministrinë. Më tutje funksionimi i dobët i kontrolleve në procesin për punë shtesë apo jashtë orarit të rregullt, rrit rrezikun e pagesave jo të sakta dhe të parregullta.
- Rekomandimi 3** Ministri duhet të sigurojë kontrolle adekuate në menaxhimin e procesit të pagave dhe orëve shtesë për personelin e Ministrisë. Pagesat të bëhen në përputhje me pozitat/koeficientet si dhe rregullat e aprovuara.

### 3.4 Menaxhimi i personelit

Ne testuam menaxhimin e proceseve në aspektin e pajtueshmërisë sa i përket menaxhimit të aktiviteteve në fushën e personelit, dhe identifikuam këto raste:

#### Çështja 4 - Mos funksionalizmi i plotë i strukturës së re organizative

- E gjetura** Pas aprovimit të rregullores së re për sistematizimin e vendeve të punës në MF edhe më tutje pozita të caktuara në disa departamente nuk janë mbuluar me zyrtarë të rregullt. Kjo dukuri vërehet në departamentin e buxhetit, politikave ekonomike, partneritetit publiko-privat, tatimit në pronë dhe në zyrën ligjore. Numri i të punësuarve aktual në këto departamente është 75, ndërsa më rregullore dhe me ligjin e buxhetit janë paraparë 84 pozita gjithsej.
- Pozita Drejtor i Departamentit të politikave makroekonomike dhe bashkëpunim ndërkombëtarë financiar që nga data 30.12.2014 nuk është e mbuluar me zyrtar të rregullt. Deri në qershor të vitit 2017 kjo pozitë ishte përcjellë me emërime/vendime për UD. Por nga data 01.06.2017 zyrtari njëjtë vazhdon të ushtroj detyrën dhe të paguhet më koeficientin e paraparë për këtë pozitë, pa ndonjë vendim për mbulimin e kësaj pozite.
- Edhe pozita udhëheqës/menaxher i divizionit të prokurimit është e mbuluar me ushtrues detyre nga data 27.07.2016 e deri tani. Rasti/procesi i menaxherit të prokurimit është në procedurë gjyqësore, andaj MF është në pritje të vendimit të gjykatës në lidhje me rregullimin e kësaj çështje.

- 
- Rreziku** Mbulimi i pozitive me ushtruese detyre jashtë afateve kohore, si dhe vonesat në plotësimin e pozitive caktuara menaxheriale me kandidatë përkatës, rrisin rrezikun që struktura e re organizative të mos jetë mjaftueshëm funksionale dhe efektive. Po ashtu rrezikon edhe arritjen e objektivave të përcaktuara.
- Rekomandimi 4** Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që të gjitha pozitat në Ministri të jenë të rregullta dhe në pajtueshmëri me strukturën organizative dhe rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës.

### 3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 2,232,001€. Prej tyre janë shpenzuar 1,551,540€, apo 70% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me shërbimet kontraktuese tjera, karburante për vetura si dhe shpenzimet e qerasë.

Buxheti final për komunalin në vitin 2017 ishte 55,445€. Prej tyre janë shpenzuar 37,735€, apo 68% e buxhetit. Këtu hyjnë shpenzimet e rrymës telefonave.

---

#### Çështja 5 - Pranimi i shërbimeve para zotimit të mjeteve dhe procedimit të urdhër blerjes

**E gjetura** Sipas rregullës së Thesarit nr. 01/2013, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procesohet urdhër-bleerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa në fjalë.

Në rastin e "Mirëmbajtja e TI" pagesa në vlerë 2,889€, zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjet janë bërë pas pranimit të faturës dhe shërbimeve, zotimi është bërë me datën 11.07.2017, urdhër blerja më 13.07.2017 ndërsa fatura është pranuar më 18.04.2017. Rast tjetër ishte në pagesën "Furnizim për zyrë" në vlerë 986€, ku zotimi i mjeteve ishte bërë me 11.10.2017 ndërsa fatura është pranuar më 06.10.2017.

**Rizik** Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme mund të rezultojë në vonesa në ekzekutimin e pagesave dhe rritjen e obligimeve të papaguara.

**Rekomandimi 5** Ministri duhet të sigurojë që kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar më LMFPP-në, dhe më rregullat e Thesarit.

### 3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere është 1,247,328€. Prej tyre janë shpenzuar 1,241,086€ apo 99.5% të cilat kanë të bëjnë me subvencionimin e entiteteve jo publike dhe transferet për Qeveritë tjera jashtë vendit për raste humaniteti/solidariteti.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2017 ishte 549,567€<sup>5</sup>. Prej tyre janë shpenzuar 498,993€ apo 91%. Më këto mjete janë realizuar dy projekte që kanë të bëjnë me furnizimin me pajisje të IT-se dhe Projekti zhvillimi i sistemeve për deponimin e të dhënave dhe integrimi i sistemeve të MF.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale. Ne testuam nga pesë procedura të prokurimit në të dy kategoritë ku identifikuam parregullsitë si ne vijim:

#### Çështja 6 – Dobësi në vlerësimin e ofertave-dhënia e kontratës OE pa i plotësuar kriteret

##### E gjetura

Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ne identifikuar se në dy raste komisioni i vlerësimit të ofertave kishte vlerësuar si të përgjegjshme dhe kishte rekomanduar nënshkrimin e kontratave me operatorët të cilët nuk i kishin plotësuar kriteret e përcaktuar me dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë:

<sup>5</sup> Në buxhetin e MF figurojnë 3,255,349€ nga të cilat 2,705,782€, janë fonde të mirëbesimit për Komunat Veriore që nuk menaxhohen nga MF. Andaj buxheti final vetëm për programet në menaxhim të MF-it ishte 549,567€.



Autoriteti kontraktues (AQP) në dosjen e tenderit për "Shërbimet e përkthimit dhe lektorimit për nevojat e Agjencive të Pavarura ", në vlerë totale indikative të kontratës 112,842€, ndër kriteret tjera, ishte edhe dëshmia për 'Marrëveshje paraprake të nënshkruar nga të dy palët (kompanisë dhe përkthyesve) për përkthime simulantë dhe përkthime më shkrim". OE fitues i kontratës. kishte ofruar listën e stafit profesional së bashku me diploma/çertifikata si dhe CV, por nuk kishte ofruar marrëveshjet paraprake. Andaj kriteri konsiderohet i pa plotësuar; dhe

Kontrata "Shërbimet bankare për nevojat e Thesarit të Kosovës" me vlerë 65,000€, operatori fitues nuk i kishte përmbushur kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Operatori ekonomik fitues i kontratës nuk ka dëshmuar se i plotëson kriteret e vendosura nga AK mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Për katër kriteret e këtij lloji OE fitues ka sjellur dy dokumente/dëshmi të cilat nuk ishin të plota dhe të mjaftueshme. Në kërkesën e AK që OE të ketë marrëdhënie me bankat korrespondentë në secilin kontinent, dëshmia e ofruar mbulon vetëm bankat në Evropë. Ndërsa dokumenti i dytë në formë elektronike (e-mail) nuk dëshmon kërkesat e AK që OE të ketë lëshuar kartela kreditore dhe për menaxhimin e llogarive të institucioneve publike në tri vitet e fundit.

#### **Rreziku**

Anashkalimi i kriterëve të dosjes së tenderit ndikon në shpërblimin e OE fitues të pa përgjegjshëm, duke rrezikuar realizimin e objektivave. Vlerësimet e tilla reduktojnë konkurrencën, transparencën dhe mund të ndikoj negativisht në vlerën për parat e shpenzuara.

#### **Rekomandimi 6**

Ministri duhet të siguroj kontrolle të mira dhe menaxhim adekuat të proceseve të prokurimit. Komisionet për vlerësimin e ofertave të mbikëqyren si duhet në mënyrë që të zbatohen ligjet, rregullat dhe të promovohet transparenca e konkurrenca me rastin e vlerësimit të ofertave.

## Çështja 7 - Vonesa në nënshkrimin e kontratës

**E gjetura** Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurim publik përcakton se periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. Periudha e kërkuar e validitetit duhet të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës.

Kontrata “Furnizimi me dhjetë kompjuter dhe monitor” në vlerë 9,540€ është nënshkruar me vonesë, jashtë validitetit të ofertës.

Njoftimi për shpalljen e fituesit është bërë me datën 14.07.2017, validiteti i ofertës ishte deri me datën 23.08.2017 përderisa kontrata është nënshkruar më datën 20.09.2017, apo pas 28 ditëve. Sipas zyrtarit të prokurimit vonesa e nënshkrimit të kontratës kishte ardhur si pasojë e mungesës së zotimit të mjeteve.

**Rreziku** Vonesa në nënshkrimin e kontratës ka ndikuar që validiteti i ofertës të kaloj afatin e paraparë dhe se kjo mund të rrezikoj realizimin e projektit në kohë dhe realizimin e buxhetit sipas rrjedhës së parasë.

**Rekomandimi 7** Ministri duhet të ndërmerri veprime për forcimin e kontrolleve në mënyrë që pas shpalljes së fituesit të kontratës dhe kalimit të afateve të ankimimeve, kontratat të nënshkruhen, me kohë/pa vonesa.

## 3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Udhëzuesi kryesor në këtë fushë është rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore. Vlera e pasurive jo financiare kapitale me vlerë mbi 1,000€ e paraqitur në PFV ishte 6,545,052€, vlera e pasurisë jo financiare vetëm për MF duke përfshirë Doganën dhe ATK është në vlerë prej 512,411€.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

### 3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2017 ishte 12,677€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Ne testuam raportet mujore të obligimeve si dhe pesë fatura të obligimeve të prezantuara në PFV. Testet tona në këtë kategori shpalosen se menaxhimi dhe raportimi i obligimeve është bërë në pajtueshmëri me legjislacionin. Ndërsa mangësi vërehen tek detyrimet kontigjente.

---

#### Çështja 8 - Detyrimet kontigjente

- E gjetura** MF nuk ka shpalosur detyrime kontigjente në PFV të vitit 2017. Ndërsa sipas listave/të dhënave të marra nga Avokatura Shtetërore (Ministria e Drejtësisë), kemi identifikuar 26 raste apo aktvendime ku janë ngritur padi ndaj MF-it. Këto të lëndë/raste nuk përmbajnë vlera financiare. Po ashtu MF nuk ka informata të mjaftueshme rreth lëndëve përkatësisht detyrimeve kontigjente.
- Rreziku** Mos shpalosja/raportimi i detyrimeve kontigjente rritë rrezikun që MF të gjendet në vështirësi financiare. Po ashtu mungesa e raportimit/shpalosjeve tregon nivelin e dobët të kontrollit në këtë fushë.
- Rekomandimi 8** Ministri duhet të siguroj kontrolle adekuate në këtë fushë, të siguroj raportim cilësorë dhe bashkëpunim me Avokaturën Shtetëror me qëllim të përfaqësimit adekuat të institucionit në gjykata.

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016, ka rezultuar me gjashtë rekomandime. MF kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, një rekomandim është zbatuar, tri ishin në proces dhe dy nuk janë zbatuar ende. Rekomandimet e pa zbatuara janë mbulimi i pozitave më ushtrues detyre jashtë afatit ligjor dhe hapja e një kodi të ri ekonomik për pagesat për investime në kapital aksionar/ekuitet me rastin e anëtarësimit ne Institucione Ndërkombëtare (kjo ndërlidhet me Thesarin).

Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe dy rekomandime të cilat janë adresuar pjesërisht. Por në vitin 2017 rezultojnë të pazbatuara ende, si, procesi i vlerësimit të ofertave jo në pajtueshmëri me kërkesat e LPP-së dhe mbulimi i pozitës me UD jashtë kërkesave ligjore.

### Çështja 9 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraparak dhe viti i mëhershëm

<b>E gjetura</b>	Nga rekomandimet e dhëna për vitin 2016-2015, tri nuk janë zbatuar ende. Ministria ka hartuar planet për zbatimin e rekomandimeve të AP, por nuk janë përcjellë dhe monitoruar si duhet. Andaj edhe më tutje nuk janë zbatuar rekomandimet që ndërlidhen me: mbulimin e pozitave me Ushtruese detyre, hapja e kodit të ri ekonomik për investime në kapital aksionar/ekuitet, procesi i vlerësimit të ofertave.
<b>Rreziku</b>	Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare dhe operative kyçe, mund të kenë ndikim në realizimin e objektivave, dhe ndikon negativisht në vlerën për parat e shpenzuara.
<b>Rekomandimi 9</b>	Ministri duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga AP, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

---

## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Në vlerësojmë progresin e bërë të MF-it sa i përket raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe përgatitjes së raportit për menaxhimin e rrezikut. Po ashtu niveli i zbatimit të rekomandimeve të vitit paraprak, është një tregues i përpjekjeve për zhvillimin e mëtutjeshëm të proceseve nga ana e menaxhmentit të MF-së. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e MF po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

MF në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Qeverisja në Ministri në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. Ministria ka adresuar me kohë zbatimin e rekomandimeve, megjithëse progresi është i ngadalshëm. MF ka përmbushë kërkesën lidhur me dorëzimin e pyetësorit të vet-vlerësimit. Lista e vet-vlerësimit e plotësuar nga MF kishte paraqitur gjendja e saktë të organizatës dhe ishte përcjelle me dëshmitë përkatëse. MF-i kishte hartuar strategjinë gjithëpërfshirëse të zhvillimit të institucionit për vitet 2017-2019, planin për menaxhimin e rreziqeve si dhe planin për monitorimin e rreziqeve.

#### 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

MF ka një sistem funksional të auditimit të brendshëm që përbënë një segment të rëndësishëm të kontrolleve në përgjithësi. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) përbëhet nga drejtori dhe shtatë zyrtarë. Është e organizuar në dy divizione, në atë për auditime në MF si dhe Divizioni për auditime jashtë MF-së, në entitete që nuk kanë të themeluara Njësinë e AB-së.

NJAB për vitin 2017 ka planifikuar të kryejë 18 auditime ndërsa janë realizuar 22. Në plan janë paraparë, 10 auditime brenda MF-së dhe tetë auditime tjera jashtë MF-së, ndërsa katër tjera me kërkesa në mënyrë ad-hoc..

Këto auditime rezultuan me të gjetura dhe rekomandime relevante, mirëpo fushëveprimi i auditimeve në masë prej 70% mbulonte aktivitetet e vitit paraprak.

Komiteti i Auditimit në MF ishte aktiv gjatë vitit 2017, duke mbajtur katër takime në të cilat është diskutuar për raportet e NJAB dhe implementimin e rekomandimeve nga këto raporte, si dhe rekomandimet e dala nga raporti i auditimit të ZKA-së për vitin 2016.

#### Çështja 10 – Fushëveprimi i auditimit kryesisht mbulon vitin paraprak

<b>E gjetura</b>	Raportet e auditimit të brendshëm në masë të konsiderueshme apo rreth 70% kanë trajtuar aktivitetet dhe sistemet operative të vitit paraprak.
<b>Rreziku</b>	Orientimi i fushëveprimit i NJAB-së në masë të konsiderueshme në vitin e kaluar, zvogëlon sigurinë apo mundësinë për ndërmarrjen e veprimeve parandaluese që mund ti ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
<b>Rekomandimi 10</b>	Ministri së bashku me Komitetin e Auditimit, duhet të sigurojnë se plani i NJAB mbështetet në masë të konsiderueshme në fushëveprimin e vitit aktual. Një qasje pro aktive do të rritë përfitimet nga NJAB dhe do të mundësojë që parregullsitë/devijimet e mundshme në sistemet e kontrollit të adresohen në kohën e duhur.

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për një planifikim të mirë, për mbikëqyrje të aktiviteteve në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti i MF ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Në kuadër të MF-së funksionojnë agjencitë ekzekutive, si: Dogana e Kosovës (DK), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) dhe Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF).

Agjencitë ekzekutive përgatisin pasqyra financiare, të cilat konsolidohen në PFV-të e MF-së. Agjencitë kanë strukturën e vet menaxheriale, përmes të cilës organizohet menaxhimi i aktiviteteve të përditshme operative. Menaxhimi dhe funksionimi i të gjitha aktiviteteve në DK dhe në ATK do të trajtohen në raporte individuale të auditimit të kryera nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Ndonëse menaxhmenti ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, MF edhe më tutje duhet t'i kushtojë rëndësi më të madhe shkallës së realizmit të buxhetit, proceseve dhe zhvillimeve në fushën e prokurimit dhe personelit.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.



158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Çështja 1 - Mos implementimi i plotë rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë	Ministri duhet të sigurojë që ka aplikuar një proces formal të monitorimit të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga AP, me qëllim që të mbaj llogaridhënës stafin përgjegjës për adresimin e rekomandimeve sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e veprimit	Po		
Çështja 2 - Lista kontrolluese e vetvlerësimit - Prioritet i lartë	Ministri duhet të iniciojë hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të institucionit, e mbështetur me planin për menaxhimin e rreziqeve potenciale që do të kërcënonin arritjen e objektivave të synuara. Po ashtu, të ndërmerren masa proaktive për adresimin e fushave me mangësi të theksuara të identifikuara në listën kontrolluese të vetvlerësimit.	Po		
Çështja 3 - Proceset e menaxhimit të rrezikut- Prioritet i mesëm	Ministri duhet të sigurojë se do të ndërmerr veprime konkrete për azhurnimin e vazhdueshëm të planit për menaxhimin e rrezikut, në mënyrë që të vendosen edhe masat e nevojshme për shmangien eventuale apo menaxhimin efektiv të rreziqeve të identifikuara	Po		

Çështja 4 - Dobësi në prokurim - Prioriteti i lartë	Ministri duhet të siguroj përmes Sekretarit të Përgjithshëm se janë forcuar kontrollet e brendshme rreth përpilimit të dosjes së tenderit dhe të vlerësimit të ofertave për të siguruar prokurime efektive dhe përzgjedhjen e ofertave më të mira të mundshme.		Rekomandimet pjesërisht te adresuara, Përpilimi i dosjeve te tenderit është bere kon formë kërkesave te LPP-se mirëpo vazhdon mos adresimi i procesit te vlerësimit te ofertave edhe ne vitin 2017 kemi identifikuar arktivite te prokurimit te cilat nuk janë zhvilluare ne pajtueshmëri me kërkesat e LPP-se	
Çështja 5 - Dobësi jo sistematike në procesin e pagesave - Prioriteti i lartë	Ministri duhet të siguroj se ka forcuar kontrollet ekzistuese me rastin e pranimin të mallrave dhe në sektorin e pagesave për të evituar pranimin e mallrave të pa kontraktuara dhe pagesën për shërbimet e papranuara	Po		
Çështja 6 - Mos respektim i LPP-së dhe ligjit të ATK-së-Prioriteti i lartë	Ministri duhet të siguroj se ka kryer një rishikim të gjithanshëm të kësaj kontrate dhe të ndërmerr veprimet e duhura që kontrata të trajtohet brenda kornizave ligjore të prokurimit	Po		
Çështja 7 - Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore - Prioriteti i lartë	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitave të caktuara me punëtorë të rregullt. Më tutje, duhet të siguroj se shpërndarja e personelit përbrenda institucionit është në harmoni me limitet e lejuara të të punësuarve sipas programeve të parapara me Ligjin e Buxhetit		Rekomandimet pjesërisht i adresuar, është adresuare çështja e shpërndarjes se personelit sipas programeve te parapara më Ligjin e buxhetit. Çështja e pa adresuar; vazhdon praktika e mbulimit të pozitave me U.D.	

Çështja 8 - Mos përdorimi i programit e-pasuria- Prioritet i mesëm	Ministri duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaqet e mos funksionimit të kontrolleve ekzistuese në këtë fushë, dhe të ndërmerr veprimet e duhura që e gjithë pasuria të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Zyrtarëve përgjegjës t'u ofrohen trajnimet e nevojshme në përdorimin e aplikacionit e-pasuria.	Po		
<b>Komponenta e auditimit</b>	<b>Rekomandimet e dhëna në vitin 2016</b>	<b>Të zbatuara</b>	<b>Në proces të zbatimit</b>	<b>Të pa zbatuara</b>
2. Pasqyrat Financiare	Ministri duhet të siguroj se ka marrë masat dhe veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuar në theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, duhet të hapet një kod i ri ekonomik – Pagesat për investime në kapital aksionar/ekuitet me rastin e anëtarësimit ne Institucione Ndërkombëtare.			Jo
2.1 Progresi ne zbatimin e rekomandimeve te viti paraprake	Ministri duhet të sigurojë se janë analizuar shkaktarët e mos zbatimit të plotë të rekomandimeve, si dhe të përcaktoj një afat të ri kohor për zbatimin e tyre, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrolleve. Ky plan duhet të monitorohet në vazhdimësi.		Po është hartuar Plani dhe afatet kohore, megjithatë progresi në zbatim është i ngadalshëm	
3.1 Planfikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të sigurojë që përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë e të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit si dhe të sigurojë se performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore. Përveç kësaj duhet të përmirësohet menaxhimi i projekteve kapitale për tu siguruar se ato përfundohen sipas afateve të kontraktuara dhe me cilësi optimale		Ky rekomandimi është adresuar pjesërisht, shkalla e realizimit të buxhetit ne kategorinë e investimeve kapitale ishte e kënaqshme, ndërsa ne kategorinë mallra dhe shërbime dhe komunalit shkalla e realizimit buxhetit arrin 70%.	

3.1.2 Paga dhe meditje	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitive të caktuara me punëtorë të rregullt dhe se pagesat për paga dhe meditje bëhen në përputhje me përshkrimin e detyrave të punës.			Jo
3.1.2 Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të sigurojë se përcaktimi i anëtarëve të komisioneve për vlerësim të tenderëve bëhet në pajtim me kërkesat e LPP, në mënyrë që të eliminohet mundësia për konflikt interesi. Kontratat duhet të lidhen vetëm me OE të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara brenda kornizave ligjore. Për me tepër çmimet e paguara duhet të bazohen në çmimet e kontraktuara.		Ky rekomandimi është adresuar pjesërisht emërimi i anëtarëve të komisionet për vlerësimin ofertave janë bere ne pajtueshmëri me kërkesat e LPP-se, mirëpo komisionet vlerësuese kanë vazhduare te bëjnë vlerësimin e ofertave jo ne pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara me dosje te tenderit.	
Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura dhe në kohë, për caktimin e zyrtarit përgjegjës të prokurimit, i cili duhet të posedojë të gjitha kualifikimet adekuate bazuar në përshkrimin e pozitës së punës.	Po		

## Shtojca III: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria e Financave  
 Ministarstvo Financija - Ministry of Finance

Zyra e Ministrit - Kancelarija e Ministrit - Cabinet of the Minister

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Financave, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Bedri Famza  
 Ministër i Financave  
 Data: 16.Prill 2018, Prishtinë